



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 06

Datë: 29. 01. 2024.

Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, krye shef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- Raportet e Këshillave të KQZ-së:**

2.1.Këshilli për Buxhet dhe Financa

-Njoftim lidhur me raportin e kontratave publike të nënshkruara nga KQZ për vitin 2023

- Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Nr.11/2024 Për Pranimin e Drejtorit të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**
 - Të ndryshme**
-

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Kreshnik Radoniqi: Kryetari Radoniqi, paraqiti rendin e ditës. Veç agjendës, ai tha se pikat e shqyrtuara nga Këshilli për Buxhet, kanë ardhur me vonesë dhe se ato do të trajtohen te kjo pikë. Ndërsa në vazhdim, anëtarët e KQZ-së nuk patën sugjerime, pyetje, propozime. Me dhjetë vota për, u miratua rendi i ditës.

2. Raportet e Këshillave të KQZ-së:

2.1.Këshilli për Buxhet dhe Financa

Njoftim lidhur me raportin e kontratave publike të nënshkuara nga KQZ për vitin 2023

Ilir Gashi, në emër të këshillit për buxhet tha se në KB janë shqyrtuar katër pika:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i anëtarësisë së KQZ-së në AËEB.

Ne, tha z. Gashi e kemi shqyrtuar, por nuk kemi vendosur ashtu që, e kemi lënë që KQZ të vendos. Buxheti është i siguruar por se varet nga ju që të miratohet...

Kjo nga këtu, është pjesë e stenogramit:

Ilir Gashi:Është pjesë ekskluzive e këtij institucioni, prandaj unë kërkojë që mos me u votue kjo rregullore sepse, ju jeni të pavarur si edhe unë, por unë jam thellë i bindur se të dy “aktgjykimet” e gjykatës Kushtetuese na mbrojnë. Pavarësisht, ngase ka ndërhyrje ligjore në këtë institucion. Mos të kërkojë askush zgjedhje të lira e të parvarurura, të mira sepse po ua lamë qeverive, kjo e ajo që vjen, kushdo, pu lëmë qasje, madje edhe kontroll. Unë, nuk mundem me votue një rregullore të këtillë e cila personin më të lartë ekzekutiv të këtij institucioni e përzgjedhin palët e jashtme. U më konsideroj që kjo nuk duhet të ndodh, është në të drejtën tonë. Nuk dua të paragjykojem, rregullorja nuk bëhet për sot, bëhet për ma gjatë! Po flas, tek pavarësia e instiucionit! Ka pasur këso tendenca, edhe në të kaluarën, asgjë nuk ka ndryshim. Edhe përpara ka pasur përpjekje, por unë nuk kam pranuar, sepse kam pasur bindje që është ndërhyrje. A jemi të mirë, të këqinjë nuk ka rëndësi por kjo është bindja ime.

Sami Hamiti: Kemi dilema, edhe unë i kam. Por, kjo nuk është as bibël dhe as kuran! Ne, mundemi mi pa edh institucionet e tjera, po nuk jam krejt i bindur edhe në atë që krejt po thua ti Ilir. Te paragrafi 2, me u reduktua, pra ky paragraf të korrigjohet...

Analizojeni!

Sami Kurteshi: Unë, kur kemi diskutuar ditën e fundit për mua është shtjerrë diskutimi. Kolegu ka pozicion të caktuar. Hiq nuk pajtohem me interpretimin e tij. Eksperti ka punue. Dilemat gjithmonë ekzistojnë, por nuk ka ligj dhe normë që është perfektë. Unë mendoj se ne duhet me vazhdua, dhe e falënderoj z. Shamolli për këtë punën e tij! Nuk ka gjë perfektë, as këto nuk jan. Këtu nuk ka varësi, nuk ka ndërhyrje. Rregulloret duhet me i miratua, me ecë përpara. Ne, e dimë që ky vit është zgjedhorë dhe ne duhet të ecim përpara...

Uën jam i interesuar shumë që ne rregulloret me i ba, me i miratue, me i nënshkrue dhe me ecë përpara...

Kreshnik Radoniqi: A po pajtohem që paragrafin 2 dhe 3 me i lanë qysh ken, apo... (nuk ka incizim)...

Më pastaj, anëtarët e KQZ u dakroduan rreth formulimeve të këtyre dy paragrafëve... dhe, pastaj anëtarët votuan: **Kreshnik Radoniqi:** Kush është për miratimin e Rregullores nr. 11/2024 Për pranimin e drejtorit të Sekretariatit të KQZ-së ?

Me 7 vota për dhe 3 kundër, anëtarët e KQZ-së e miratuan këtë rregullore.

Nuk ka stenogram – material tjetër për zbardhje – procesverbal...

